

Llapushnik/Lapušnik [Glogoc/Glogovac]. Katër ditë më vonë, më **24.07.1998**, forcat serbe e kanë sulmuar Llapushnikun/Lapušnik dhe Rifadija me prindër dhe fëmijë e kanë braktisur fshatin dhe u nisën drejt fshatit **Berishë/Beriša**. Kanë arritur në fshat nga ora 13:00. U ndalën për të pushuar. Por, një predhë ka rënë afro 30 metra larg tyre. Një cifël e ka qëlluar Doruntinën afër syrit të majtë. Rifadija me të atin u nisën menjëherë për ta çuar Doruntinën në Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan], ku gjendej ambulanca e UÇK-së. Udhëtimi ka zgjatur për dy orë. Megjithatë, Doruntina ndërroi jetë në ambulancë nga ora 20:00. E ëma dhe gjyshi e kanë varrosur në varrezat e Kleçkës/Klečka, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata R.K, FDH-40576; J. Osmani, *Krimet...*, I, 537.

Ahmet (Rexhep) Kelmendi

(15.03.1980, shqiptar nga Balinca/Balince, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënës)

Ahmeti me prindërit, vëllezërit dhe motrat e veta e braktisën Balincën/Balince më 22.06.1998, kur Ushtria e Jugosllavisë e nisi bombardimin e fshatit nga drejtimi i Lapushnikut/Lapušnik. Si edhe vendasit e tjerë, ata u strehuan në një pyll, në vendin e quajtur *Lugu i Bunarit*. Në fshat kishin mbetur vetëm pjesëtarët e UÇK-së dhe disa civilë që nuk deshën t'i braktisnin shtëpitë e veta. Po atë ditë, por më vonë, në fshat [**Balincë/Balince**] u kthyen Ahmeti dhe axha i tij Sylejmani. Ahmetin e kanë vrarë në pragun e shtëpisë më **27.07.1998**. E kishin qëlluar me armë zjarri nga drejtimi ku ishin të pozicionuara forcat serbe. Të nesërmen, Sylejmani e ka varrosur Ahmetin në varrezat e Gollubocit/Golubovac, pasi e mori lejen e policisë serbe. Pas luftime, në muajin qershor të vitit 2000, mbetjet mortore të Ahmetit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Balincë/Balince.

Burimi: deklarata S.K, FDH-17549.

Veseli (Zenel) Gashi

(20.01.1925, shqiptar nga Balinca/Balince, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, shtatë fëmijë)

Xhevë (Kadri) Gashi

(15.10.1925, shqiptare nga Balinca/Balince, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, shtatë fëmijë)

Veseli i moshëthyer me bashkëshorten Xhevën jetonin te i biri Hamdiu dhe familja e tij. Që të gjithë rastisën të ishin në shtëpi, kur, më **27.07.1998**, UJ-a filloi t'i bombardonte pozicionet e UÇK-së në fshat [**Balincë/Balince**]. Banorët e fshatit, të cilët nuk i kishin braktisur shtëpitë në muajin qershor, apo ata që në ndërkohë ishin kthyer, u larguan me vrap nga fshati. Veseli dhe Xheva nuk deshën të largoheshin nga shtëpia. Me ta ndenjen edhe djemtë Hamdiu, Haxhiu dhe Ismeti, si dhe nipërit Adrijani dhe Dritoni. Intensiteti i bombardimit u rrit me kalimin e kohës dhe familjarët e morën Veselin dhe Xhevën dhe u nisën drejt qendrës së fshatit. Xhevën e palëvizshme e kanë lënë në shtëpinë e Metë Gashit, e cila konsiderohej më e sigurt se sa shtëpitë e tjera të fshatit. Veselin e morën me vete në pyll. Të nesërmen, më **28.07.1998**, Veseli u nis për në fshat, me qëllim shpëtimin e bashkëshortes. Nga ajo ditë, familjarët nuk kishin kurrfarë njohuri për të. Pas kthimit në fshat në muajin tetor të vitit 1998, familjarët kanë mësuar nga një organizatë ndërkombëtare se Xhevën e kishin varrosur në oborrin e Metë Gashit. Familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e saj mortore në varrezat e fshatit Balincë/Balince. Trupi i Veselit u zbulua në muajin janar të vitit 1999 në afërsi të shtëpisë së të vëllait Nuredinit. E kishte një dëmtim në anën e majtë të kokës, afër veshit. Edhe Veselin e kanë varrosur në varrezat e fshatit. Pas luftime, në muajin maj të vitit 2001, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Veselit dhe Xhevës në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Balincë/Balince.

Burimet: deklarata H.G, FDH-15143; deklarata H.G, FDH-34634; J. Osmani, *Krimet...*, I, 535; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D298.1.4, FDH-30924.

Murat (Rexhep) Kryeziu

(27.11.1944, shqiptar nga Bubaveci/Bobovac, komuna e Malishevës/Mališevo, korrier, gjashtë fëmijë)